



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 760 Akti

Nr. 806 Vendimi
Tiranë, më 9.10.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 2.10.2024, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Roland Agolli**, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore,

shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, bisedoi çështjen në tërësi, si dhe pasi përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Roland Agolli, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Roland Agolli është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2021, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Roland Agolli do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Etleda Çiftja dhe Firdes Shuli (relatore). Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga Komisioni janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 15.6.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Roland Agolli, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 17.9.2024, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Roland Agolli; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 e 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 18.9.2024, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas

nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 30.9.2024; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Me vendimin nr. 3, datë 30.9.2024, u caktua data e seancës dëgjimore dhe iu njoftua subjektit të rivlerësimit. Në datën 2.10.2024, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

8. Në datën 9.10.2024 u shpall vendimi për subjektin e rivlerësimit Roland Agolli.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

9. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

10. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

11. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

12. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së, sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI I VLERËSIMIT TË PASURISË

13. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, i cili ushtronte detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë *Vetting* në datën 28.1.2017, me nr. indeksi ***.

14. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Roland Agolli ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2018, në të cilin ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim pasurie ndër vite; (ii) ka mungesë burimesh financiare dhe dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Roland Agolli.

16. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

17. Tri sipërfaqe tokë arë, trajtuar si vijon:

17.1. *Tokë arë në bashkëpronësi me prindërit dhe motrën, me sipërfaqe 5.740 m², pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, fshati ***, Njësia Administrative ***, Bashkia Durrës. Zotërues 25%. Burimi i krijimit: përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.*

Nga aktet në dosjen ILDKPKI, rezulton se subjekti ka paraqitur AMTP-në nr. ***, datë 23.1.1997, sipas së cilës familjes së shtetasit L. N. A. i është dhënë në pronësi tokë gjithsej 9.600 m², si dhe certifikatë pronësie me hartën treguese, sipas së cilës pasuria nr. ***, e llojit arë, me sip. 5.740 m², me adresë fshati ***, Durrës, figuron në emër të babait të subjektit, z. L. A., si përfaqësues i familjes.

17.2. *Tokë arë në bashkëpronësi me prindërit dhe motrën, me sipërfaqe 2.124 m², pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, fshati ***, Njësia Administrative ***, Bashkia Durrës. Zotërues 25%. Burimi i krijimit: përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.*

Nga aktet në dosjen e ILDKPKI, rezulton se subjekti ka paraqitur AMTP-në nr. ***, datë 23.1.1997, sipas së cilës familjes së shtetasit L. N. A. i është dhënë në pronësi tokë gjithsej 9.600

m², si dhe certifikatë pronësie me hartën treguese, sipas së cilës pasuria nr. ***, e llojit arë, me sip. 3.124 m², me adresë fshati ***, Durrës, figuron në emër të babait të subjektit, z. L. A., si përfaqësues i familjes.

17.3. Tokë arë në bashkëpronësi me prindërit dhe motrën, me sipërfaqe 917 m², pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, fshati ***, Njësia Administrative ***, Bashkia Durrës. Zotërues 25%. Burimi i krijimit: përfutuar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.

Nga aktet në dosjen ILDKPKI, rezulton se subjekti ka paraqitur AMTP-në nr. ***, datë 23.1.1997, sipas së cilës familjes së shtetasit L. N. A. i është dhënë në pronësi tokë gjithsej 9.600 m², si dhe certifikatë pronësie me hartën treguese, sipas së cilës pasuria nr. ***, e llojit arë, me sip. 917 m², me adresë fshati ***, Durrës, figuron në emër të babait të subjektit, z. L. A., si përfaqësues i familjes.

17.4. Në lidhje me këto pasuri, pas verifikimeve në përfundim të hetimit u konstatua se:

- Sipas certifikatës familjare datë 17.10.2016, të paraqitur nga subjekti, gjendja familjare në datën 1.8.1991 përbëhej nga subjekti, prindërit e tij dhe motra A. A. Sipas AMTP-së nr. ***, datë 23.1.1997, familjes së shtetasit L. N. A. (babai i subjektit) i janë dhënë në pronësi tokë gjithsej 9.600 m², të ndara në 3 parcela, konkretisht parcela nr. *** me sip. 3.150 m², parcela nr. *** me sip. 850 m² dhe parcela nr. *** me sip. 5.600 m².

- Me kërkesë të ILDKPKI-së, ZVRPP Durrës nuk i ka konfirmuar pasuritë nr. ***, nr. *** dhe nr. ***, të llojit arë, në emër të subjektit të rivlerësimit apo në emër të babait të tij, si përfaqësues i familjes bujqësore.

- Me kërkesë të Komisionit, ASHK Drejtoria Vendore Durrës nuk ka përcjellë të dhëna për pronësinë e pasurive të sipërpërmendura, me sqarimin se sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme nuk është i informatizuar për të gjitha zonat kadastrale dhe për këtë arsye informacioni i dërguar mund të mos jetë i saktë.

- Me pyetësozin nr. 2 i është kërkuar subjektit që të vendosë në dispozicion kartelat përkatëse për të tria pasuritë, në përgjigje të të cilit subjekti deklaroi se për këto tri pasuri, të cilat figurojnë në emër të babait të tij, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2018, nuk është marrë asnjëherë kartelë pasurie dhe se pa u kryer veprimet për çeljen e trashëgimisë ligjore dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë nuk mund të aplikohet për kartela të pasurive përkatëse në ASHK.

17.5. Sa i takon gjendjes faktike dhe statusit aktual, u kryen verifikimet si vijojnë:

- Nga verifikimi në sistemin ASIG duket se në pasuritë nr. *** dhe nr. *** ndodhen ndërtesa të pasqyruara si në ortofoton e vitit 2007, ashtu edhe në atë të vitit 2018, ndërsa në pasurinë nr. *** nuk vërehen ndërtesa. ASIG-u ka informuar, duke përcjellë edhe pamjet e fotografimeve ajrore, nga të cilat rezulton se: (i) në pasurinë nr. ***, z. k. ***, nuk rezulton gjurmë objekti në fotografimet ajrore 2007 – 2008 dhe 2015 – 2017, ndërsa ortofotoja e vitit 2018 nuk përfshin territorin ku gjendet kjo pasuri. Nga pamjet e fotografimeve ajrore të pasurisë, vërehet se në pasurinë nr. ***, z. k. ***, sipas ortofotove me datë fotografimi 8.7.2007 dhe 18.5.2015, nuk rezulton ndërtesë; (ii) në pasurinë nr. ***, z. k. ***, sipas kuotave në ortofotot e viteve 2007, 2015 dhe 2018 rezulton ndërtesë me lartësi pothuajse të njëjtë; (iii) për pasurinë nr. ***, z. k. ***, janë

përcjellë vetëm ortofotot e viteve 2015 dhe 2018, ku në bazë të kuotave të pasqyruara duket një ndërtesë me lartësi pothuajse të njëjtë.

- ASHK Drejtoria Vendore Durrës ka informuar se subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja e tij dhe prindërit nuk rezultojnë të jenë aplikues në procesin e legalizimit.

- Në pyetësin nr. 2 i është kërkuar subjektit të japë informacion mbi gjendjen faktike dhe juridike të këtyre pasurive, duke e shoqëruar me çdo lloj dokumentacioni pronësie, posedimi etj., si dhe fotografi me datë aktuale të tyre, periudhën dhe vlerën e investimeve, burimin e krijimit, nga kush përdoren këto pasuri aktualisht, pjesën e kontributit nga ana e tij nëse ka.

- Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka sqaruar se ndërtimi i ndodhur në pasurinë nr. *** është ngrehinë për mbajtjen e veglave të punës për punimin e tokës bujqësore, e ndërtuar nga babai i tij pas marrjes së tokës me ligjin nr. 7501. Gjendja e saj sot është e njëjtë si në vitin 2018 dhe nga ana e tij nuk ka pasur asnjë kontribut në të dhe nuk përdoret nga askush, pasi edhe toka bujqësore nuk është përdorur më pas vdekjes së babait të tij. Subjekti ka vënë në dispozicion disa foto, ku tregohet gjendja e objektit nga jashtë dhe duket se ndërtesa është një ngrehinë e pabanueshme. Për sa i takon ndërtesës së ndodhur në pasurinë nr. ***, subjekti ka deklaruar se ajo është ndërtim pa leje, ndërtuar pa pëlqimin e pronarit të tokës nga persona të panjohur prej subjektit dhe familjarëve të tij, për të cilën ai nuk ka ndonjë informacion nëse është legalizuar nga ALUIZNI, si dhe nuk ka dijeni se nga kush përdoret sot.

- Në pyetësin nr. 4, në lidhje me pasurinë nr. *** iu kërkuar subjektit të informojë dhe të paraqesë dokumente në lidhje me pronësinë e ndërtesës dhe kontributet financiare që kanë shërbyer në investim, me qëllim që të vërtetohet se ai dhe familjarët e tij nuk kanë lidhje apo kontribute në këtë pasuri. Subjekti informoi se i është drejtuar për informacion ASHK-së Drejtoria Vendore Durrës dhe paraqiti disa dokumente shkresore¹, që vërtetojnë se ndërtimi është kryer dhe regjistruar nga shtetasi S. V. Konkretisht, nisur nga genplani i pasurisë nr. ***, fragmenti i hartës kadastrale dhe harta treguese e kësaj pasurie, duket se objekti ndodhet mbi pasurinë nr. *** objekt verifikimi dhe nuk ka lidhje dhe nuk është në pronësi të subjektit, po të shtetasit S. V., i cili ka kaluar në procedura të legalizimit të objektit.

17.6. Në përfundim të hetimit, sa i takon ndërtimeve të konstatuara mbi pasuritë nr. *** dhe nr. ***, Komisioni duke u nisur nga faktet si:

i) sipas ASIG-ut, ndërtesat rezultojnë se ekzistojnë që në vitin 2007, pra rreth 8 vjet para se subjekti të emërohet si ndihmës ligjor dhe në një periudhë kur nuk ka qenë subjekt deklarues, ndërkohë që në përgjigje të pyetësit nr. 4 subjekti ka deklaruar dhe ka vërtetuar me të dhëna të Gjendjes

¹ Shihni kartelën e pasurisë nr. *** ND, të llojit ndërtesë me sip. 126,63 m², në adresën ***, Durrës, regjistruar në datën 12.7.2017 në emër të shtetasit S. V., me përshkrimin leje legalizimi godinë banimi 1 kat me sipërfaqe përdhe 126,63 m² dhe fragmentin e hartës kadastrale; lejen e legalizimit datë 27.1.2017 për godinën e banimit 1-katëshe, ndodhur në ***, Bashkia Durrës, në emër të shtetasit S. L. V., për pasurinë nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m², sipërfaqe ndërtimi 126,63 m², me shënimin se titulli i pronësisë mbi tokën do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave me hipotekë ligjore; genplanin e pasurisë nr. ***, si dhe planimetrinë e katit përdhe, depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësit nr. 4 në dosjen e Komisionit.

Civile, se ai ka bashkëjetuar me prindërit deri në vitin 1999 dhe më pas ka bashkëjetuar me bashkëshorten dhe fëmijët²;

ii) në deklaratën *Vetting*, subjekti përveç faktit të bashkëpronësisë mbi tokën për shkak të ligjit, nuk ka deklaruar që të ketë përfituar të ardhura nga këto pasuri;

iii) subjekti dhe personat e lidhur nuk janë aplikues në proces legalizimi;

iv) gjatë procesit, sikurse edhe subjekti deklaroi, nuk ka të dhëna mbi një pronësi të mundshme të subjektit mbi këto objekte apo që ai të ketë kontribuar në ndërtimin e tyre, ndërkohë që në njëërën prej pasurive u vërtetua që ndërtimi është kryer nga një shtetas tjetër;

vlerësoi se nuk ka investime të kryera nga subjekti mbi pasuritë objekt vlerësimi, tokë arë të përfituara nga ligji nr. 7501 “Për tokën”, nga babai i tij si kryefamiljar, të cilat edhe pse nuk ishin të regjistruara në Zyrën e Regjistrimeve në pronësi/bashkëpronësi të subjektit, ky i fundit i ka deklaruar në deklaratën *Vetting* sipas ligjit, duke paraqitur AMTP dhe dokumente shkresore.

18. *Apartament në bashkëpronësi me bashkëshorten 2+1, me sipërfaqe 61 m² dhe sipërfaqe trualli 33,49 m², nr. *** regjistri hipotekor, pallati ***, z. k. ***, fshati ***, Njësia Administrative ***, Bashkia Durrës. Përfituar 25% nëpërmjet blerjes në datën 13.12.1994, sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992. Pjesa prej 75%, blerë nga prindërit dhe motra në datën 3.11.2004, me të ardhurat nga puna ime dhe e bashkëshortes. Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

18.1. Nga hetimi rezultoi se me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.11.2004, subjekti i cili ka pasur pronësinë e 25% të pasurisë apartament 2+1, me sipërfaqe 61 m², ka blerë 75% pjesë takuese të bashkëpronarëve të tjerë, në çmimin 500.000 lekë. Pasi u verifikua origjina dhe mënyra e fitimit të pronësisë nga subjekti në periudhën kur nuk ka qenë në detyrë dhe as subjekt deklarues, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të hetimit nuk u konstatuan problematika.

18.2. Sa i takon përdorimit të kësaj pasurie, i është kërkuar informacion subjektit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se ndër vite ky apartament është përdorur nga familja e tij A., duke sqaruar se deri në vitin 2018 kanë banuar vetëm prindërit L. e A. A. Me vdekjen e babait në vitin 2018, nëna e tij ka shkuar të banojë me të në Durrës (në apartamentin trajtuar në vijim), ndaj ky apartament nuk përdoret më nga askush dhe është në gjendje të pabanueshme). Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit foto të cilat tregojnë gjendjen e apartamentit.

18.3. Në lidhje me burimin e krijimit, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar saktë ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” si burim të 25% të pjesës takuese në pasurinë e përfituar nëpërmjet aktit të blerjes me në datë 13.12.1994 së bashku me familjarë të tij. Ndërsa për 75% të përfituar me kontratën e shitblerjes me kontratën e datës 3.11.2004 nga familjarë të tij, bashkëpronarë të pasurisë, në çmimin prej 500.000 lekësh, ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes, për të cilat ka paraqitur disa dokumente shkresore. Nga Komisioni u krye analiza financiare me të dhënat që disponoheshin për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortes së tij për të paguar në datën 3.11.2004 shumën

² Subjekti ka paraqitur certifikatë familjare me datë 17.7.2024, sipas së cilës përbërja familjare datë 1.1.2011 përbëhet nga subjekti, bashkëshortja dhe tre fëmijët. Nga verifikimi në sistemin e Gjendjes Civile 2008, familja e subjektit përbëhet nga ai, bashkëshortja dhe dy fëmijët. Fëmija i parë ka lindur më 31.8.1999.

500.000 lekë. Si burim të ardhurash janë përfshirë të ardhurat e dokumentuara gjatë periudhës 15.9.2003 – 3.11.2004³, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme të kryente pagesën e shumës prej 500.000 lekësh. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

19. *Apartament në bashkëpronësi me bashkëshorten 1+1, me sipërfaqe 56,73 m², pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, Lagjja Nr. ***, rruga “****”, Durrës. Blerë në datën 13.1.2005, me të ardhurat nga puna ime dhe e bashkëshortes. Vlera 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

19.1. Nga hetimi rezultoi se me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.1.2005, subjekti ka blerë pasurinë nr. ***, në çmimin 500.000 lekë. Pasi u verifikua origjina dhe mënyra e fitimit të pronësisë nga subjekti në periudhën kur nuk ka qenë në detyrë dhe as subjekt deklarues, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të hetimit nuk u konstatuan problematika.

19.2. Sa i takon përdorimit të kësaj pasurie, me *email*-in e datës 20.6.2024 subjekti ka vënë në dispozicion librezën e energjisë elektrike, që i përket kontratës nr. ***, e cila është aktive dhe figuron e regjistruar në emër të shtetasit R. F. (i cili është vjehri i subjektit) dhe ka sqaruar se kjo kontratë figuron në emër të këtij shtetasi, pasi që nga momenti që është blerë ky apartament e deri në vitin 2021 është banuar nga prindërit e bashkëshortes së tij, ndërsa nga viti 2021 e në vazhdim në këtë apartament banon kunata e tij A. N. me familjen e saj, duke qenë se banesa e saj ka pësuar dëmtime nga tërmeti i datës 27.11.2020 dhe ende nuk ka përfunduar rikonstruksioni i banesës së saj.

19.3. Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.1.2005, me çmim 500.000 lekë, likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes, për të cilat ka paraqitur disa dokumente shkresore. Në përfundim të hetimit, është kryer analiza financiare me të dhënat që disponoheshin, për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortes së tij, ku burim të ardhurash janë përfshirë të ardhurat e dokumentuara gjatë periudhës 4.11.2005 – 13.1.2005⁴, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së, nga ku dukej se subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme të blejë apartamentin e banimit në rrugën “****”, Durrës, në shumën 500.000 lekë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

20. *Apartament në bashkëpronësi me bashkëshorten 2+1, me sipërfaqe 83,8 m², pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, Lagjja Nr. ***, rruga “****”, pallati *** (sot ***), shk. ***, kati ***, ap. ***, Durrës. Blerë me të ardhurat nga shitja e një apartamenti në Lagjen Nr. ***, rruga*

³ Analiza financiare është kryer e fragmentuar duke filluar nga data 16.9.2003, pasi para kësaj periudhe subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë ***. Për më shumë detaje shihni analizën në formatin Excel.

⁴ Analiza financiare është kryer e fragmentuar duke filluar nga data 4.11.2004, pasi para kësaj periudhe subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit në Sukth në vlerën 500.000 lekë dhe pagesën e shumës 7.000 euro për kontratën e sipërmarrjes së datës 3.11.2004. Për më shumë detaje shihni analizën në formatin Excel.

“***”, Durrës, të blerë nga shoqëria e ndërtimit “***” sh.p.k. me kontratën e sipërmarrjes datë 3.11.2004. Vlera 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

20.1. Pasi u verifikua origjina dhe mënyra e fitimit të pronësisë nga subjekti sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2007, kundrejt çmimit 1.800.000, periudhë kur ai nuk ka qenë në detyrë dhe as subjekt deklarues, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të hetimit nuk u evidentuan problematika.

20.2. Në lidhje me përdorimin e pasurisë, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë banimi adresën e këtij apartamenti, Lagjja Nr. ***, rruga “***”, pallati ***, shkalla ***, kati ***, hyrja ***, Durrës. Në pyetësorin standard, ka deklaruar se nga momenti i marrjes së detyrës (në vitin 2015) ka banuar në këtë adresë banimi. Sa i takon shpenzimeve për mobilimin e banesës, subjekti ka deklaruar se janë kryer që në vitin 2010 në tërësi dhe shkojnë afërsisht në vlerën 1.500.000 lekë dhe për shkak të kohës së kaluar është në pamundësi për të dhënë vlerën e blerjes për secilën. Gjithashtu ka deklaruar se ndër vite janë bërë vetëm zëvendësime të pajisjeve të cilat kanë dalë jashtë funksionit, kryesisht elektrike, me vlera të njëjta apo të përafërta me të parat.

20.3. Në lidhje me çmimin e blerjes dhe mënyrën e likuidimit rezultoi se sipas kontratës së shitblerjes datë 10.5.2007 çmimi i apartamentit nr. *** është 1.800.000 lekë, shumë e cila është likuiduar e plotë *cash* jashtë zyrës noteriale. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se vlera e apartamentit është 4.000.000 lekë dhe ka paraqitur kopje të dokumentit bankar urdhërpagesë e brendshme e kryer në ProCredit Bank në datën 28.4.2007, me urdhërues Roland Agolli dhe përfitues Dh. T., në shumën prej 3.798.321 lekësh, me përshkrimin “Kalim fondi për blerje shtëpie”. Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit konstatohet debitimi i (pagesa) kësaj shume në datën 28.4.2007, me përshkrimin “Kalim fondi për blerje shtëpie”. Për shkak të mospërputhjes midis çmimit faktik të deklaruar nga subjekti prej 4.000.000 lekësh, çmimit të paguar sipas urdhërpagesës prej 3.798.321 lekësh dhe çmimit sipas kontratës së shitblerjes prej 1.800.000 lekësh, iu kërkuan sqarime subjektit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 sqaroi se:

- Çmimi i blerjes së apartamentit me nr. pasurie ***, është 4.000.000 lekë. Me anë të dokumentit bankar në ProCredit Bank rezulton se është paguar shuma 3.798.321 lekë, ndërsa diferenca, në marrëveshje verbale me shitësin, është lënë si garanci deri në daljen e certifikatës së pronësisë në emrin e subjektit dhe me daljen e certifikatës së pronësisë ia ka dhënë blerësit dorazi.

- Sa i takon çmimit të përcaktuar në kontratë, subjekti deklaroi se, duke qenë se për likuidimin e vlerës së apartamentit veprimet i ka kryer nëpërmjet bankës, ai nuk i ka kushtuar rëndësi çmimit të vendosur në kontratë, me mendimin se është vendosur vlera për të cilën ai kishte rënë dakord me shitësin. Subjekti sqaroi se këtë fakt ai e ka konstatuar pasi kontrata ishte regjistruar në ZVRPP dhe kishte dalë certifikata e pronësisë. Siç vërehet, pavarësisht se subjekti e ka deklaruar çmimin real në deklaratën *Vetting*, ai ka nënshkruar kontratën e shitjes në të cilën çmimi i shitjes është i pavërtetë, veprim ky i cili duket të jetë kryer për efekt të favorizimit të palës shitëse për të mos paguar detyrimet tatimore mbi çmimin 4.000.000 lekë. Në përfundim të hetimit, çmimi i blerjes së pasurisë është konsideruar ai i deklaruar në deklaratën *Vetting* prej 4.000.000 lekësh.

20.4. Duke qenë se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se si burim për blerjen e pasurisë kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e një apartamenti në Lagjen Nr. ***, rruga “***”, Durrës, të

porositur nga shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k. me kontratën e datës 3.11.2004, nga Komisioni u kryen disa verifikime në lidhje me këtë pasuri, nga ku u konstatua se:

- Subjekti ka paraqitur kontratën e lidhur mes shoqërisë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga shtetasi L. A. në cilësinë e sipërmarrësit dhe Roland Agolli në cilësinë e porositesit, me vërtetim nënshkrimi nga noteri nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.11.2004, nëpërmjet së cilës ka porositur ndërtimin e një apartamenti prej 67,3 m², në objektin 12 kate që ishte duke ndërtuar shoqëria në rrugën “****”, kundrejt çmimit 30.000 euro. Referuar kontratës, kalimi i pronësisë do të bëhet pasi të jetë paguar kësti i fundit i çmimit të apartamentit, likuidimi i të cilit do të bëhet në 2 këste: (a) 12.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës; (b) 18.000 euro në momentin e marrjes në dorëzim të apartamentit. Subjekti ka paraqitur: (a) mandatin nr. ***, datë 2.11.2004, në vlerën 7.000 euro, me përshkrimin “Pagesë e këstit të parë të apartamentit tip ***, 1+1, në katin e **** të objektit 12 kate”; (b) mandatin nr. ***, datë 4.9.2006, në vlerën 4.000 euro, me përshkrimin “Pagesë për këstin e fundit të apartamentit të blerë në kullën 12 kate****”. Pra, në total është paguar vlera 11.000 euro.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se likuidimi i pjesës së mbetur është bërë me anë të kredisë bankare në shumën 15.000 euro, e marrë prej tij në NBG Bank, e cila vërtetohet me kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.3.2005 dhe vërtetimin e NBG Bank datë 25.1.2017, kredi që është likuiduar totalisht në vitin 2020. Sipas kontratës që subjekti ka paraqitur, kredia është marrë me qëllim blerjen e apartamentit të banimit në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, Durrës (kjo kredi është deklaruar dhe trajtuar te rubrika “Detyrimet financiare”). Pjesa tjetër prej 400 euro (duhet të jetë lapsus pasi kishin mbetur pa u paguar 4.000 euro), sipas subjektit i është paguar shoqërisë “****” sh.p.k., pas kalimit të vlerës 15.000 euro nga kredia bankare në llogari të shoqërisë, por fatkeqësisht ai nuk e disponon mandatin e pagesës.

- Komisioni iu drejtua ASHK-së Durrës me qëllim për të marrë informacion lidhur me origjinën e pronës dhe të gjitha transaksionet e kryera deri në pronësinë aktuale për apartamentin e prenotuar nga subjekti në rrugën “****”, Durrës, duke i bashkëngjitur kërkesës kontratën e porosisë dhe ASHK-Durrës nuk konfirmoi që kjo pasuri të ishte e regjistruar në emër të subjektit Roland Agolli.

- Komisioni iu drejtua shoqërisë “****” sh.p.k., e cila ashtu sikurse edhe subjekti ka deklaruar, informoi se z. Agolli bazuar në kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.11.2002, për prentim të apartamentit me sip. 67,3 m², ka derdhur në llogarinë e tyre bankare shumën 14.630 euro, në datën 6.4.2005; ka derdhur në arkën e shoqërisë shumën 7.000 euro me mandatin nr. ***, datë 3.11.2004; si dhe shumën 4.000 euro me mandatarkëtimin nr. ***, datë 5.9.2006. Për shumën 4.370 euro nuk vërtetohet pagesa me një dokument shkresor. Po kështu informon se nuk e disponon kontratën e shitblerjes së këtij apartamenti dhe nuk ka asnjë informacion në lidhje me gjendjen aktuale të tij sot. Siç vërehet, nga shoqëria “****” sh.p.k. nuk vërtetohet blerja e pasurisë me një kontratë shitjeje përfundimtare të apartamentit prej 67,3 m², në rrugën “****”, në çmimin 30.000 euro prej subjektit, por është pohuar të jetë lidhur kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.11.2002. Siç do të trajtohet në vijim, shoqëria informon se subjekti e ka shitur këtë pasuri te shtetasi Gj. N. pa e blerë vetë me një kontratë noteriale shitblerjeje dhe pa e pasur të regjistruar në Hipoteke dhe se kontrata përfundimtare e shitjes për këtë pasuri është lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe këtij shtetasi.

- Në lidhje me shumën 14.630 euro, të kaluar në llogarinë bankare të shoqërisë, nga verifikimi i dokumenteve bankare rezultoi se subjektit i është disbursuar kredia në shumën 15.000 euro, në datën 31.3.2005 dhe në datën 1.4.2005 subjekti ka urdhëruar transferimin e shumës 14.630 euro për shoqërinë “****” sh.p.k. Përfitimi i kësaj shume në datën 6.4.2005 konfirmohet nga shoqëria.

- Sa i përket vlerës së apartamentit të porositur prej 30.000 euro, në përgjigje të pyetësorit datë 29.7.2024 subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer 15.000 euro kredi bankare dhe 15.000 euro kursime. Për efekt të kryerjes së analizës financiare nga ana e Komisionit u verifikuan dy burimet e deklaruara të krijimit sipas subjektit, konkretisht 15.000 euro kredi bankare dhe 15.000 euro kursime.

- Në lidhje me burimin e krijimit kredi bankare, trajtuar hollësisht në pikën 1 tek detyrimet financiare, rezultoi se deklaratimet e subjektit përputhen dhe provohen me aktet e administruara. Konkretisht, nisur nga veprimi bankar në llogarinë e subjektit dhe konfirmimit të pagesës së përfituar në datën 6.4.2005⁵ nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k., u vërtetua që shuma prej 14.630 euro, paguar në datën 1.4.2005, është me burim kredinë e marrë në NBG Bank, vërtetuar me kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.3.2005.

- Sa i takon burimit të dytë të deklaruar nga subjekti, kursime në shumën 15.000 euro, Komisioni verifikoi mundësinë e krijimit të tyre në datat e kryerjes së pagesave, si vijon: (i) 7.000 euro paguar në datën 2.11.2004 nisur nga mandatarkëtimi i depozituar nga subjekti; (ii) 4.370 euro paguar brenda vitit 2005 sipas deklaratimit të subjektit në pyetësorë; (iii) 4.000 euro paguar në datën 4.9.2006 nisur nga mandatarkëtimi i depozituar subjekti. Në analizën financiare shumat 7.000 euro, 4.370 euro dhe 4.000 euro, me burim kursimet, janë përfshirë si shpenzime të subjektit, nga ku rezulton se ai nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për t’i kursyer këto shuma.

20.5. Sa i takon të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit të porositur pranë shoqërisë “****” sh.p.k., të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit nr. *** objekt vlerësimi në vitin 2007, nga dokumentet e paraqitura nga subjekti dhe deklaratimet e tij, vërehet se:

- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij apartamenti. Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.4.2007, ku deklaruesit Roland Agolli dhe Gj. N. kanë deklaruar se në datën 28.4.2007 z. Roland Agolli ka marrë nga shtetasi Gj. N. shumën prej 4.420.000 lekësh, si vlerë për shitjen e apartamentit në Lagjen Nr. ***, rruga “****”, Durrës.

- Subjekti ka paraqitur kopje të urdhërpagesës së brendshme të kryer në ProCredit Bank në datën 28.4.2007, sipas së cilës shtetasi Gj. N. i ka kaluar z. Roland Agolli vlerën prej 3.798.321 lekësh, me përshkrimin “Kalim fondi për blerje shtëpie...”. Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit konstatohet kreditimi i kësaj shume. Kjo shumë në po të njëjtën datë 28.4.2007 ka kaluar në llogari të shtetases Dh. T. nga subjekti për blerjen e apartamentit me nr. pasurie ***, objekt vlerësimi.

- Duke qenë se rezultoi të kishte mospërputhje mes çmimit të përcaktuar në deklaratën noteriale prej 4.420.000 lekësh dhe vlerës prej 3.798.321 lekësh të kaluara në rrugë bankare, iu kërkua

⁵ Diferenca në kohë midis datës së kryerjes së pagesës nga ana e subjektit 1.4.2005 dhe përfitimit të saj nga ana e shoqërisë 6.4.2005, ka ndodhur për shkak se transfertat është urdhëruar në fundjavë. Paga është bërë e vlefshme pas 4 ditësh, pasi 2 ditë kanë qenë pushim dhe 2 ditët e tjera konsiderohen si koha normale e kryerjes së një veprimi bankar në monedhë të huaj.

subjektit të sqarojë dhe të saktësojë çmimin e shitjes së këtij apartamenti dhe mënyrën e përfitimit të shumës.

- Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 4 subjekti ka deklaruar që vlera prej 4.420.000 lekësh, përcaktuar në deklaratën noteriale, i është likuiduar e gjitha në datën 28.4.2007, duke sqaruar se vlera prej 3.798.321 lekësh/30.000 euro i është derdhur nga shtetasi GJ. N. në llogarinë e tij bankare pikërisht për shkak se subjekti këtë shumë do ta kalonte në llogarinë bankare të shitësit të shtëpisë që po blinte (pra në llogari të shtetasës Dh. T. për blerjen e apartamentit me nr. pasurie ***, objekt vlerësimi, ashtu sikurse edhe është provuar nga dokumentacioni bankar). Ndërsa diferencën, subjekti ka deklaruar se e ka marrë dorazi, deklarim i cili nuk u mor në konsideratë, pasi mbeti në nivel deklarativ. Subjekti shpjegoi se, me qëllim që të mos kryheshin shumë veprime në lidhje me kthimin e shumës nga shoqëria e ndërtimit tek subjekti për shkak të tërheqjes nga kontrata, shoqëria ka rënë dakord me shtetasin GJ. N. që këtë apartament t'ia shiste këtij të fundit. Më pas, ndërmjet shoqërisë së ndërtimit "****" sh.p.k. dhe shtetasit GJ. N. është lidhur kontrata për kalimin e pronësisë dhe pronësia në ZVRPP është regjistruar për këtë apartament në emër të këtij shtetasi. Sa i përket pagimit të tatimit mbi të ardhurën nga shitja⁶, sqaroi se shuma e marrë me deklaratën noteriale nuk ka qenë e ardhur e përfituar nga shitja në mënyrë që të paguhej tatimi mbi të ardhurat dhe se ky tatim është paguar nga shoqëria e ndërtimit pas shitjes së apartamentit shtetasit GJ. N. dhe regjistrimin e pronësisë në ZVRPP në emër të tij. Për të vërtetuar deklaratimet e tij, subjekti ka paraqitur⁷: (i) certifikatë pronësie datë 19.9.2005 dhe kartelë të pasurisë për apartamentin nr. **, në pronësi të shoqërisë "****" sh.p.k.; (ii) kontratë shitjeje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 18.9.2007, sipas së cilës shoqëria "****" sh.p.k. i shet shtetasit GJ. N. një apartament me sip. 67 m², që ndodhet në Lagjen Nr. **, rruga "****", Durrës, në çmimin 2.700.000 lekë; (iii) kartelë të pasurisë së llojit apartament me nr. pasurie **, me sip. 67 m², me adresë Lagjja Nr. **, rruga "****", Durrës, shk. **, ap. **, në pronësi të shtetasit Gj. N. N.

- Me kërkesë të Komisionit, shoqëria "****" sh.p.k. konfirmoi se ka nënshkruar kontratën e porosisë me z. Roland Agolli dhe se prej tij janë likuiduar pagesat. Po kështu informoi se këtë apartament subjekti ia ka shitur shtetasit GJ. N. , vërtetuar me deklaratë noteriale dhe se pas kësaj deklarate noteriale pronësia i ka kaluar këtij shtetasi.

20.6. Në përfundim të hetimit të pasurisë objekt vlerësimi, apartament me nr. pasurie ** në Durrës, është konsideruar se vlera e pasurisë është 4.000.000 lekë sipas deklaratimit të subjektit në deklaratën *Vetting*. Si burim për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit shtetasit GJ. N. në shumën 3.798.321 lekë, vërtetuar me veprimin bankar të datës 28.4.2007, ekuivalente me shumën 30.000 euro, të cilën subjekti e kishte paguar më herët për porositjen e këtij apartamenti. Në lidhje me ligjshmërinë e kësaj shume, në kushtet kur nuk ka një kontratë noteriale të shitjes dhe duke qenë se apartamenti është shitur me të njëjtën vlerë që është blerë, subjekti nuk ka realizuar fitim mbi të cilin do të kishte detyrimin për të paguar tatimin mbi të ardhurat. Në këto kushte, kjo shumë është konsideruar e ligjshme. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 201.679 lekë (4.000.000 -

⁶ Subjekti dha të njëjtin sqarim edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

⁷ Shihni dokumentet e paraqitura në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe pyetësorit datë 29.7.2024.

3.798.321 = 201.679 lekë) për blerjen e pasurisë apartament me nr. *** në Durrës, në vlerën 4.000.000 lekë.

21. *Autoveturë tip “Mercedes-Benz”, në bashkëpronësi me bashkëshorten, me nr. shasie ***, viti prodhimit 1984. Blerë në datën 15.9.2003 me të ardhurat nga puna ime dhe e bashkëshortes. Regjistruar në DPSHTRR Durrës me nr. leje qarkullimi ***. Vlera 200.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.*

21.1. Në lidhje me këtë automjet të blerë gjatë periudhës që subjekti nuk ka qenë në detyrë dhe as subjekt deklarues, nga aktet e vëna në dispozicion nga DPSHTRR-ja rezulton se sipas certifikatës së pronësisë datë 14.11.2002 (italiane), mjeti me targë ***, nr. shasie ***, figuron në pronësi të shtetasit S. B. S. Sipas vërtetimit të zhdoganimit datë 18.9.2003, shtetasi S. B. S. ka kryer zhdoganimin e mjetit, ndërsa sipas deklaratës doganore vlera e tij është 200.000 lekë dhe shpenzimet doganore janë 150.987 lekë. Sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.9.2003, shtetasi S. B. S. i shet z. Roland Agolli këtë mjet kundrejt çmimit 200.000 lekë. Sipas certifikatës së pronësisë datë 13.4.2008 mjeti u regjistrua me targë *** në pronësi të z. Roland Agolli.

21.2. Nga Komisioni është kryer analiza financiare, ku duket se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e mjetit. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

22. Në rubrikën detyrimet financiare subjekti ka deklaruar:

22.1. *Kredi bankare në shumën 15.000 euro, me datë fillimi 25.3.2005 dhe datë mbarimi 25.3.2020, kontrata e kredisë me NBG Bank nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.3.2005. Interesi bazë në momentin e lidhjes së kontratës 9.8%, numri i kësteve mujore 180. Kësti mujor në momentin e lidhjes së kontratës 160.44 euro. Me shtesën e kontratës datë 10.3.2016, interesi i kredisë është ndryshuar në 7.4% dhe kësti mujor për periudhën 25.3.2016 – 25.3.2020 është 158,27 euro. Detyrimi i mbetur është në vlerën 5.468 euro. Pas verifikimeve, trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë detyrim financiar, pasi përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin shkresor të administruar.*

22.2. *Detyrim financiar ndaj shkollës së mesme *** *** për periudhën 2014 – 2017, në shumën 75.000 lekë, taksë regjistrimi që paguhet vetëm një herë dhe 120.000 lekë në vit, pagesa vjetore për shkollimin e fëmijës L. A. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer është 40.000 lekë. Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë detyrim financiar, pasi përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e depozituar.*

23. Personi i lidhur, bashkëshortja M. A., e cila në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* është pjesë përbërëse e familjes, ka deklaruar të njëjtat pasuri dhe detyrime financiare të deklaruara edhe nga subjekti i rivlerësimit, të trajtuara më sipër.

KONSTATIME TË TJERA

24. Komisioni kreu verifikime në lidhje me konstatimin e ILDKPKI-së për mosdeklarim në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të të ardhurave të përfituara nga Bashkia Sukth, në shumën 926.353

lekë, nga Gjykata Administrative Durrës, në shumën 1.005.337 lekë dhe nga pagat e konfirmuara nga DRT Durrës, për periudhën 2008 – 2011, në shumën 665.700 lekë.

Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasaktësi për shkak të mosdeklarimit të të ardhurave të përfituara nga Bashkia Sukth, për sa kohë në deklaratën *Vetting* nuk kërkohet të deklarohen të ardhurat e realizuara para fillimit të detyrës. Sa i takon mosdeklarimit të të ardhurave të përfituara nga Gjykata Administrative Durrës, pra nga fillimi i detyrës, u konstatua se subjekti nuk i ka deklaruar siç kërkohet në deklaratën *Vetting*, por për sa kohë ka paraqitur dokument që provon këto të ardhura, përmendur në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, vlerësohet vetëm si pasaktësi në plotësimin e deklaratës pa ndonjë peshë specifike.

25. Komisioni kreu verifikime në lidhje me konstatimin e ILDKPKI-së se deklarimi i subjektit për të ardhurat e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën totale 6.480.000 lekë, nuk konfirmohen sipas vërtetimit të paraqitur dhe shkresës së shoqërisë. Konkretisht, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar punësimin pranë shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. për periudhën shtator 2000 – dhjetor 2005 dhe të ardhurat e përfituara prej saj. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të ILDKPKI-së, ai ka paraqitur vërtetimin e lëshuar në datën 1.12.2004 nga shoqëria “****” sh.p.k., e cila konfirmon punësimin e shtetasit Roland Agolli në detyrën e drejtuesit të zyrës juridike, prej së cilës paguhet me pagë mujore prej 100.000 lekësh, pa futur këtu shpenzimet për siguracionin dhe taksat mbi pagën. Nga informacioni i ISSH-së Lundër dhe ISSH-së Durrës në lidhje me të ardhurat neto për periudhën 2000 – 2005, kur subjekti ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k., nuk ka pasur të dhëna në listëpagesat ku të figurojë emri i subjektit.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, u vlerësua se vërtetimi i lëshuar nga kompania “****” sh.p.k., në datën 16.4.2018, nuk vërteton përfitimin e të ardhurave të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në vlerën 6.480.000 lekë, në periudhën 2003 – 2005, e për pasojë kjo shumë nuk u konsiderua si e ardhur e ligjshme për krijimin e ndonjë pasurie. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime e të paraqesë dokumente shkresore për të provuar legjitimitetin e të ardhurave.

26. Komisioni kreu verifikime në lidhje me konstatimin e ILDKPKI-së se deklarimi i subjektit për të ardhurat e përfituara nga avokatia në shumën totale 7.200.000 lekë nuk konfirmohen referuar përgjigjeve të DRT-së Durrës dhe Dr. Tatimeve Bashkia Durrës.

26.1. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se ka ushtruar aktivitetin privat avokat si person fizik me adresë Lagjja Nr. ***, rruga “****”, Durrës, me NIPT ***, për periudhën shtator 2008 – qershor 2011 dhe ka përfituar vlerat: (i) shtator – dhjetor 2008 në vlerën 1.800.000 lekë; (ii) viti 2009 në vlerën 2.000.000 lekë; (iii) viti 2010 në vlerën 1.900.000 lekë; (iv) janar – qershor 2011 në vlerën 1.500.000 lekë. Pasi u administruan të dhënat nga një numër i konsiderueshëm dokumentesh shkresore të paraqitura nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, informacionin e kërkuar dhe marrë nga ILDKPKI-ja, informacionin e kërkuar dhe marrë nga Komisioni gjatë procesit, trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, si dhe bazuar në faktet se: (a) nga viti 2007 deri në vitin 2013 tatimpaguesit e biznesit të vogël kaluan në administrimin e organeve vendore dhe referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, bizneset

me qarkullim deri në 2 milionë lekë paguanin detyrim fiskal të fiksuar për çdo kategori biznesi⁸, ndërsa bizneset me qarkullim vjetor 2-8 milionë lekë paguanin edhe tatim mbi të ardhurat personale; (b) deklarimi dhe pagesa e tatimit për bizneset me qarkullim mbi 2 milionë bëhej pranë ish-degëve të tatimeve, sot drejtoritë rajonale tatimore – në përfundim të procesit, Komisioni i ka konsideruar të ardhura të përfituara nga aktiviteti privat si avokat.

- Për vitin 2008, bazuar në qarkullimin e deklaruar në Bashki, fitimi i përlllogaritur do të ishte në vlerën 960.000 lekë.

- Për vitin 2009, fitimi i përlllogaritur nga Komisioni në masën 880.000 lekë (80% të qarkullimit vjetor), bazuar në qarkullimin faktik të deklaruar në Bashki për vitin 2009 prej 1.100.000 lekësh dhe normën e fitimit prej 80% sipas praktikës së ndjekur në Komision⁹. Pavarësisht se subjekti ka depozituar në Tatime formularin e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitin 2009 me vlerë 0 (zero) në të gjitha rubrikat, Bashkia Durrës ka depozituar dokumentacion që pasqyron pagesën e detyrimeve për vitin 2009.

- Për vitin 2010, fitimi i përlllogaritur nga Komisioni në masën 800.000 lekë (80% të qarkullimit vjetor), bazuar në qarkullimin faktik të deklaruar në Bashki për vitin 2010 prej 1.000.000 lekësh dhe normën e fitimit prej 80%, sipas praktikës së ndjekur në Komision¹⁰. Pavarësisht se subjekti ka depozituar në Tatime formularin e deklarimit dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitin 2010 me vlerë 0 (zero) në të gjitha rubrikat, Bashkia Durrës ka depozituar dokumentacion që pasqyron pagesën e detyrimeve për vitin 2010.

- Për vitin 2011, fitimin e përlllogaritur nga Komisioni në masën 400.000 lekë (80% të qarkullimit për 6-mujorin e parë të vitit), bazuar në qarkullimin e parashikuar të deklaruar në Bashki për vitin 2011 dhe normën e fitimit prej 80% sipas praktikës së ndjekur në Komision¹¹, si dhe bazuar në konfirmimin nga Bashkia Durrës për pagesën e detyrimeve për 6-mujorin e parë të vitit 2011.

26.2. Në përfundim të hetimit për periudhën e ushtrimit të aktivitetit të avokatisë, nuk u vërtetua që subjekti të ketë përfituar shumë prej 7.200.000 lekësh për periudhën 2008 – 2011, por bazuar në informacionin e Bashkisë Durrës, që konfirmon se subjekti ka ushtruar aktivitet privat si avokat, ka krijuar qarkullim, si dhe ka paguar detyrimet fiskale të kësteve fikse për taksën mbi biznesin e vogël, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të këtyre viteve të ardhurat në shumë 2.960.000 lekë sipas përlllogaritjeve si më sipër. Vlen të theksohet se këto të ardhura nuk janë deklaruar dhe nuk kanë rezultuar të kenë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie.

27. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka sqaruar me detaje vendet se ku ka udhëtuar jashtë shtetit, duke sqaruar qëllimin e udhëtimit, me kë ka qenë i shoqëruar dhe se sa kanë qenë kostot e shpenzimeve të kryera prej tij dhe familjarëve. Nga hetimi i Komisionit rezultuan disa targa automjesh, me të cilat sipas sistemit TIMS ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit dhe

⁸ Shihni aneksin nr. 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” Kategoria I: Bashkitë Tiranë dhe Durrës; Kategoria II: Bashkitë Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat, Lezhë dhe Kavajë; Kategoria III: Bashkitë - të gjitha bashkitë e tjera.

⁹ Shihni vendimin për subjektin P. Gj.

¹⁰ Shihni vendimin për subjektin P. Gj.

¹¹ Shihni vendimin për subjektin P. Gj.

bashkëshortja e tij, për të cilat iu kërkua që të japë informacion në pyetësoin nr. 2 në lidhje me pronarët e mjeteve, qëllimin e udhëtimeve dhe destinacionin. Në përgjigjen e dhënë, subjekti ka sqaruar se në pronësi të kujt kanë qenë mjetet me të cilat kanë udhëtuar ai dhe bashkëshortja e tij, qëllimin e udhëtimeve dhe destinacionet përkatëse. Në lidhje me personat me të cilët ka udhëtuar apo ka qëndruar gjatë udhëtimit subjekti i rivlerësimit, SPAK ka informuar se nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal apo pasuror për shtetasit e listuar në kërkesë. Për sa i takon shpenzimeve të bëra nga subjekti dhe personat e lidhur me të nga sistemi TIMS për periudhën deri në deklarinimin *Vetting*, ato janë përlogaritur nga Komisioni sipas standardit të Kolegjit dhe kanë rezultuar në vlerën 239.626 lekë.

Analiza financiare

28. Në përfundim të hetimit administrativ, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor Komisioni kreu analizën financiare, sipas së cilës dukej se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve para detyrës për shkak të një balance negative prej -6.105.862 lekësh dhe gjatë detyrës me një balancë negative prej -45.326 lekësh, pra në total -6.151.188 lekësh.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT DHE VLERËSIMI I KOMISIONIT

29. Subjekti nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim për rezultatet e hetimit administrativ, por me *email*-in e datës 30.9.2024 ka njoftuar se është dakord me rezultatet e hetimit të Komisionit. Edhe në seancë dëgjimore subjekti e deklaroi këtë fakt, duke u shprehur në mënyrë të përmbledhur se:

- Subjekti, pasi ka dalë në reformë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në vitin 2000, me përpjekjet e tij ka arritur të sigurojë një marrëdhënie pune me shoqërinë “****” sh.p.k., me të cilën nuk ka nënshkruar asnjëherë një kontratë pune. Për shkak të marrëdhënies shumë të mirë që ka ekzistuar në fillim mes tij dhe administratorit të shoqërisë, ishte rënë dakord që përveç pagës shoqëria të merrte përsipër edhe shpenzime të tjera, përfshirë këtu pagesën e qirasë së shtëpisë, si dhe i ka premtuar subjektit se do t’i jepte edhe një apartament me koston e ndërtimit të asaj kohe, i cili ishte në vlerën 20.000 lekë ose 200 euro për metër katror. Duke qenë se në atë kohë vetë shoqëria “****” sh.p.k. nuk kishte apartamente, u dakordësua që të paguante te një shoqëri tjetër një apartament për subjektin e rivlerësimit, pikërisht apartamentin me sipërfaqe 61 m², ku ka banuar për disa vite bashkë me të dy fëmijët dhe bashkëshortën e ndjerë. Në momentin e prishjes së marrëdhënies së subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k., prej kësaj të fundit ishin paguar vlerat e dy mandateve prej 7.000 euro dhe 4.000 euro (të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni), edhe pse ky fakt nuk është pasqyruar në dokumentet e pagesës, ndërsa për pjesën e mbetur është marrë kredi, e cila është likuiduar në vitin 2020. Për shkak se për këtë apartament nga shoqëria nuk ishte kryer asnjë veprim për pajisjen me certifikatë pronësie dhe subjekti në atë kohë kërkonte të largohej nga ky apartament për shkak të kushteve të papërshtatshme dhe nevojës për zgjerim, u dakordësua me shtetasin GJ. N. që ky të blinte apartamentin dhe të lidhte kontratën me shoqërinë dhe subjekti të merrte mbrapsht shumën e paguar shoqërisë. Kjo shumë ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit me sip. 83,4 m², që disponon edhe sot.

- Në lidhje me shtëpinë në fshat (apartament 2+1 me sip. 61 m²), subjekti ka shpjeguar se faktikisht ajo është fituar nëpërmjet dhurimit nga prindërit dhe motra, pavarësisht se kalimi i pronësisë është

bërë me kontratë shitblerjeje për shpejtësi veprimesh noteriale, për arsye se subjekti kërkonte ta linte si hipotekë për marrjen e kredisë për shtëpinë që do të blinte, edhe pse në fund kjo pronë nuk u pranua nga banka. Pra, subjekti lë të kuptohet se realisht nuk e ka paguar shumën 500.000 lekë.

- Për sa i takon shtëpisë në rrugën “****”, subjekti ka shpjeguar se kjo shtëpi rezulton të jetë sot në emër të fëmijëve të tij dhe në emrin e tij në masën 50% së bashku dhe në masën 50% në emër të tezes së fëmijëve të tij, për shkak se kjo banesë ka qenë e vjehrrit dhe është blerë me të ardhurat e tij, i cili ka ardhur nga Elbasani dhe ka shitur një shtëpi dhe ka blerë një shtëpi tjetër në Durrës. Mirëpo, duke qenë se në atë periudhë ai pati probleme dhe u alkoolizua, familjarët nga frika se mund të kishte lënë shtëpinë, ranë dakord që shtëpia të vendosej në emër të subjektit për ta mbrojtur.

- Po kështu, subjekti ka deklaruar në seancën dëgjimore se ka pasur gjithë jetën e tij vetëm një automjet të tipit “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1984, ndërsa mobilimi i shtëpisë realisht nuk ka kushtuar 10.000 euro, por kjo shumë është shkruar ngaqë ndihej keq në raport me kolegët e tij, pasi nëse do të shihej, shtëpia ka një mobilim fare minimalist, i cili nuk ka shkruar më tepër se 5 milionë lekë të vjetra dhe ato janë të mbledhura vetëm nga puna e bashkëshortes së tij, e cila punonte dhe qepte gjithë natën në makinë. Gjithashtu, ai ka deklaruar se makinën të cilën përdor sot, ia ka sjellë djali, i cili punon në Gjermani dhe se ai nuk ka pasur ndonjëherë të ardhura të tjera e as llogari bankare, si dhe nuk ka qenë ndonjëherë i përfshirë në veprimtari korruptive në gjykatë.

- Në lidhje me vijimin e punësimit pas shkëputjes nga detyra të ndihmës gjyqtarit në vitin 2000, i pyetur në seancë dëgjimore, subjekti ka sqaruar se pas ndryshimeve që iu bënë Kodit të Procedurës Penale, nuk u parashikua më institucioni i ndihmës gjyqtarit, ndaj pas daljes në reformë ai është gjendur në rrugë, pa asnjë ndihmë financiare. Sipas deklarimeve të bëra nga subjekti, ai ka tentuar disa herë duke dërguar kërkesa pranë Ministrisë së Drejtësisë për t’u emëruar si gjyqtar, mirëpo kanë rezultuar pa sukses, ndaj i është dashur shumë mund e sakrificë për të gjetur një punë tjetër si për vete, ashtu edhe për bashkëshorten e tij si mësuese.

30. Përpara procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni risjell në vëmendje se:

- Z. Roland Agolli është bërë subjekt deklarues në vitin 2017;
- Në periudhën 1996 – 2000 ka ushtruar profesionin e ndihmës gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
- Në periudhën 2000 – 2005 ka qenë i punësuar si jurist në subjektin privat “****” sh.p.k.;
- Në periudhën mars 2006 – janar 2007 ka qenë i punësuar pranë “Hekurudha Shqiptare” sh.a.;
- Në periudhën shtator 2008 – qershor 2011 ka ushtruar profesionin e avokatit;
- Në periudhën korrik 2011 – qershor 2013 ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Sukth, Durrës;
- Për periudhën 2013 – shtator 2015 nuk ka të dhëna (subjekti nuk ka deklaruar të ardhura, si dhe nuk rezulton të ketë qenë i punësuar në këtë periudhë).

31. Në përfundim të procesit, bazuar në të gjitha provat e administruara, Komisioni, vlerëson se:

- Subjekti, i cili më parë nuk ka qenë subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 84/2016, si subjekt i këtij ligji, ka deklaruar saktësisht në deklaratën *Vetting* për çdo pasuri të krijuar përpara fillimit të detyrës në vitin 2015, në periudhën 2004 – 2007, duke dhënë sqarime të hollësishme në lidhje me përfitimin ligjor të pasurive ndër vite, bazuar në

dokumentacionin ligjor që ka mundur të sigurojë për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave.

- Në vijim, gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka qenë konsistent me deklaratimet e mëparshme të tij, duke iu përgjigjur me korrektesë e brenda afateve të caktuara pyetjeve, që faktikisht konsistonin në çfarë Komisioni ka konstatuar edhe në përfundim të procesit me kalimin e barrës së provës, kryesisht për pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të blera apo të shitura përpara se subjekti të fillonte detyrën e ndihmësit ligjor, kur subjekti nuk ka qenë në asnjë vit subjekt deklarues. Parë në këtë këndvështrim, Komisioni nuk e vlerëson negativisht mosparaqitjen nga ana e subjektit të parashtrimeve apo ndonjë dokumenti të krijuar rishtazi pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ. Përkundrazi, vlerëson pozitivisht dakordësinë e tij me konstatimet e Komisionit, si dhe pohimin në seancë dëgjimore se pasi është liruar nga detyra e ndihmës gjyqtarit në vitin 2000, ka kryer çdo lloj pune për të mbajtur familjen, duke nënkuptuar kështu që nuk mund të vërtetohet të ardhura të ligjshme nga shoqëria “****” sh.p.k., ku sipas vërtetimit të lëshuar nga shoqëria ka punuar si jurist gjatë periudhës që ka krijuar pasuritë. Nga ana tjetër, nuk u administrua asnjë e dhënë dhe asnjë denoncim për subjektin e rivlerësimit që të hidhte qoftë dhe ndonjë hije dyshimi në lidhje me veprimtari të kundërligjshme të tij për shkak të korrupsionit dhe jo vetëm, e cila mund të kishte shërbyer si burim i të ardhurave të tij ndër vite.

- Sa i takon nënshkrimin të kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2007, për blerjen e pasurisë nr. ***, në çmimin 1.800.000 lekë, Komisioni çmon se, pavarësisht deklaratimeve të subjektit gjatë procesit, sipas të cilit nuk i ka kushtuar rëndësi çmimit në kontratë pasi çmimi real ishte paguar në rrugë bankare, subjekti duhet të ishte treguar i kujdesshëm gjatë procedurave të blerjes dhe nënshkrimit të kontratës. Por, nisur nga fakti që subjekti ka deklaruar saktësisht çmimin në deklaratën *Vetting*, i cili i ka kaluar në rrugë bankare palës shitëse, si dhe faktit që detyrimi për të paguar tatimin mbi të ardhurat nga shitja i përkiste palës shitëse, pra jo subjektit, ky element, parë në raport me të dhëna të tjera të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, nuk u çmua si shkak penalizues në disfavor të subjektit të rivlerësimit.

- Në konsideratë të sa më sipër, si dhe faktit që subjekti nuk u vërtetua të ketë krijuar ndonjë pasuri a likuiditet pas vitit 2007, mungesa e burimeve të ligjshme në shumën -6.105.862 lekë, krijuar në kohën kur subjekti nuk ishte në detyrën e ndihmësit ligjor të ushtruar në vitin 2015, si dhe nuk ushtronte ndonjë funksion tjetër publik për të cilin të kishte detyrimin e deklaratimit të pasurive, e për rrjedhojë të tregonte kujdesin e duhur për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të përdorura për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve jetike, vlerësohet se nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit. Nga ana tjetër, Komisioni mban në konsideratë se e gjithë analiza financiare, duke përfshirë edhe periudhën përpara fillimit të detyrës, për efekt të një vlerësimi sa më objektiv në kuadër të ligjit nr. 84/2016, është kryer sipas standardit të ndjekur edhe për subjektet që kanë qenë subjekte deklaruese që në vitin 2003, të cilët kanë pasur detyrimin për të deklaruar pasuritë, të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, likuiditetet në bankë a në gjendje *cash*.

- Në procesin e vendimmarrjes, në një vlerësim tërësor dhe harmonik të rrethanave të sipërpërmendura, trupi gjykues çmoi se në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës

dhe nenit 30 te ligjit nr. 84/2016, për subjektin Roland Agolli mungesa e burimeve të ligjshme duhet të jetë në vlerën e shumatores së pamjaftueshmërisë financiare për krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting* dhe të krijuara para detyrës, konkretisht: (i) apartamentit 2+1, me sipërfaqe 61 m², në vlerën 500.000 lekë; (ii) apartamentit 1+1, me sipërfaqe 56,73 m² në vlerën 500.000 leke; (iii) apartamentit 2+1, me sipërfaqe 83,8 m² në vlerën 201.679 lekë; (iv) automjetit me targë *** në vlerën 200.000 lekë; në total -1.401.679 lekë. Diferenca prej 4.704.183 lekësh, ndikuar më së shumti nga mosmarrja në konsideratë e të ardhurave nga punësimi në shoqërinë “***” sh.p.k. në periudhën 2000 – 2005, si dhe përlllogaritja e shpenzimeve të ndryshme në periudhën 1996 – 2015 sipas standardit të Komisionit pasi është kryer një analizë financiare gjithëpërfshirëse, vlerësohet se në respektim të parimit të objektivitetit nuk mund të jetë penalizuese, për sa kohë subjekti nuk ka pasur detyrim për deklarim të pasurive, të të ardhurave të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, shpenzimeve të jetesës (dhe jo vetëm) të cilat për nga natyra në rastin konkret u vërtetua të kenë qenë shpenzime bazike.

- Në vijim të këtij arsyetimi, nëse balancës negative për krijimin e pasurive për periudhën para detyrës prej -1.401.679 lekësh, të deklaruara në deklaratën *Vetting*, i shtohet edhe mungesa e burimeve të ligjshme prej -45.326 lekësh gjatë ushtrimit të detyrës, pamjaftueshmëria financiare totale prej -1.447.005 lekësh, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit, si dhe referuar faktit që në pjesën me të madhe i përket periudhës para detyrës, e cila nuk është pasuar me krijimin e ndonjë pasurie të re të çdo lloji deri në deklaratën *Vetting*, nuk arrin deri në atë nivel që ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë.

KONTROLI I FIGURËS

32. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit Roland Agolli, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 9.5.2024, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Roland Agolli. Pasi është kërkuar përditësimi i të dhënave, ka rezultuar se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin Roland Agolli. SPAK ka informuar se nuk rezulton që në emër të shtetasit Roland Agolli të jetë regjistruar ndonjë procedim penal ose pasuror. Po kështu, nuk ka pasur të dhëna dhe nuk u evidentuan marrëdhënie apo kontakte të subjektit me persona me precedentë penalë të çdo lloji.

32.1. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte/rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës të AKSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Roland Agolli është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

33. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, janë kryer verifikime për të bërë rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Roland Agolli, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor me nr. *** prot., datë 9.5.2023; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

34. Raporti i përcjellë nga KLGJ-ja duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional – nuk ka evidentuar problematika dhe ka vlerësuar pozitivisht subjektin e rivlerësimit. Pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioni nuk ka konstatuar problematika.

35. Nga verifikimi i Komisionit rezulton se me shkresën e përcjellë në Komision nga Shkolla e Magjistraturës, ndihmësi ligjor i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, z. Roland Agolli, rezulton se ka marrë 57 pikë në testin e përgjithshëm dhe 134 pikë në testin profesional, në total 191 pikë.

36. Nga informacioni i marrë nga burime të ligjshme rezulton se në lidhje me subjektin e rivlerësimit Roland Agolli pranë Komisionit nuk ka ardhur asnjë denoncim.

37. Në konkluzion përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk janë konstatuar mangësi profesionale, për rrjedhojë z. Roland Agolli ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

SEANCA DËGJIMORE

38. Në datën 2.10.2024, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvilluan seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Roland Agolli, në përfundim të të cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Roland Agolli dhe shpalli vendimin në seancën e datës 9.10.2024, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

39. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi u është përgjigjur me korrektësi dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime/deklarime për informacionin e kërkuar bazuar në dokumente shkresore, të cilat kanë qenë konsistente me deklaratimet në deklaratën *Vetting*, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Roland Agolli ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.

- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Roland Agolli ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Roland Agolli ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Roland Agolli, ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 9.10.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Firdes SHULI
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana